

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6-15

Olympus Foods Tirana sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,233,881	3,702,353
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	253,642	57,217
Total aktive afatshkurtra		1,487,523	3,759,570
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	47,798	-
Total aktive afatgjata		47,798	-
Total aktive		1,535,321	3,759,570
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	7	71,063	337,677
Detyrime tatimore	8	53,764	102,667
Të tjera detyrime	9	200,434	379,351
Total detyrime afatshkurtra		325,261	819,695
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		325,261	819,695
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	10	3,792,300	3,792,300
Rezerva të tjera		(852,426)	-
Fitimi i ushtrimit		(1,729,814)	(852,425)
Total kapitali		1,210,060	2,939,875
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,535,321	3,759,570

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
 Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
 (Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Performancës
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	11	307,938	(84,070)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(1,463,108)	(352,903)
1) Të tjera shpenzime	12	(1,463,108)	(352,903)
Shpenzime të personelit	13	(567,114)	(415,452)
1) Paga dhe shpërblime		(448,361)	(356,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(118,753)	(59,452)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6	(5,523)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	14	(2,007)	-
Shpenzime financiare		-	-
Fitimi/ humbja para tatimit		(1,729,814)	(852,425)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15	-	-
Fitimi/ humbja e vitit		(1,729,814)	(852,425)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(1,729,814)	(852,425)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Rezultati i ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar më 12 shtator 2018	-	-	-	-
Rezultati i ushtrimit	-	-	(852,425)	(852,425)
Emetimi i kapitalit	3,792,300	-	-	3,792,300
Lëvizje nëpërmjet kapitalit	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	3,792,300	-	(852,425)	2,939,875
Rezultati i ushtrimit	-	-	(1,729,814)	(1,729,814)
Emetim i kapitalit	-	-	-	-
Lëvizje nëpërmjet kapitalit	-	(852,425)	852,425	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	3,792,300	(852,425)	(1,729,814)	1,210,061

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Olympus Foods Tirana sh.p.k më 23 mars 2020 dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Andreas Beletsiotis
Administrator

OLYMPUS FOODS TIRANA SH.P.K
Rr. "Emin Duraku", Pall. "Binjakët", Nr. 5
Tiranë - Shqipëri
NUIS: L82112027S

Mazars Shpk

Mazars Sh.p.k
Hartues i Pasqyrave Financiare

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjakët",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@mazars.al

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / humbja e vitit	(1,729,814)	(852,425)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	11,301	89,698
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	5,523	-
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Rënie/ (rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(196,425)	(57,217)
Rritje/ (rënie) në detyrimet e pagueshme	(306,403)	534,248
Rritje/ (rënie) në detyrime për punonjësit	(188,032)	285,447
Mjete monetare neto nga/ (përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(2,403,850)	(249)
Fluksi i parasë nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(53,321)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(53,321)	-
Fluksi i parasë nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	3,792,300
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	3,792,300
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(2,457,171)	3,792,051
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	3,702,353	-
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(11,301)	(89,698)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 1,233,881	3,702,353

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacioni i përgjithshëm

Shoqëria Olympus Foods Tirana" sh.p.k. është themeluar më 06 shtator 2018 dhe është regjistruar më 12 shtator 2018 në Regjistrin e Shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është prodhimi industrial dhe tregtimi i prodhimeve bulmetore, djathrave, gjithë llojet e ushqimeve të lëngshme si dhe atyre të përgatitura, etj.

Administratori i Shoqërisë është Z. Andreas Beletsiotis.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L82112027S. Selia qendrore e saj është në: Njësia Bashkiake nr 5, rruga 'Emin Duraku', Pallati 'Binjakët', Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 ishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2010 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më datë 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe paraqiten neto në zërin "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Normat e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 janë 5 % nëse të ardhurat arrijnë deri në 14 000 000 lekë në vit dhe 15 % nëse të ardhurat janë mbi 14 000 000 lekë në vit.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
 (Vlerat janë në Lekë)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	1,233,881	3,702,353
	1,233,881	3,702,353

5. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH e arkëtueshme	188,822	57,217
Garanci për qera	63,320	-
Garanci për modem	1,500	-
	253,642	57,217

6. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Pajisje kompjuterike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-
Shtesa	5,825	47,496	53,321
Gjendja më 31 dhjetor 2019	5,825	47,496	53,321
<i>Amortizimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-
Amortizimi i vitit	(734)	(4,789)	(5,523)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(734)	(4,789)	(5,523)
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	5,091	42,707	47,798

7. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë vendas	65,715	337,677
Furnitorë për fatura të pa mbëritura	5,348	-
	71,063	337,677

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
 (Vlerat janë në Lekë)

8. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	32,255	27,900
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	12,012	9,100
Tatim në Burim	9,497	-
Taksa Vendore	-	65,667
	53,764	102,667

9. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime ndaj personelit	97,416	285,447
Financime nga Mazars Shpk	98,152	93,904
Komisione të akumuluar bankare	487	-
Financime Andreas Beletsiotis	4,379	-
	200,434	379,351

10. Kapitali

Kapitali I nënshkruar i shoqërisë Olympus Foods Tirana sh.p.k. më 31 dhjetor 2019 është 3,792,300 Lekë.

Humbja e vitit është 1,729,814 Lekë.

11. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(20,162)	(89,698)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	4,416	5,628
Të ardhura nga paga të pamarrë	323,684	-
	307,938	(84,070)

11. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi me deklaratimet mujore të TVSH-së dhe Tatimit mbi fitimin

Rakordimi I të ardhurave me deklaratimet mujore të TVSH-së dhe deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin për vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	-
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	-
Shitje produkte të gatshme	
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	-
Të ardhura nga paga të pamara	323,684
Fitim nga këmbimet valutore	4,416
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	328,100

12. Shpenzime të tjera

Shpenzimet të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime konsulence ekonomike	542,436	286,087
Shpenzime qiraje apartament punonjësi	445,151	-
Taksa vendore	197,000	65,667
Shpenzime utilitete e mirëmbajtje apartamenti për punonjësin	75,559	-
Shpenzime shërbimi nga Hellenic Daires	60,216	-
Shpenzime ndërmejtësimi për gjetje apartamenti	38,154	-
Shpenzime telefonie	37,165	-
Shpenzime noteriale	21,600	-
Shpenzime bankare	20,614	1,149
Të tjera	13,243	-
Kancelari	11,970	-
	1,463,108	352,903

13. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	448,361	356,000
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	118,753	59,452
	567,114	415,452

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 ishte 1 punonjës.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lekë)

14. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018
Gjoha për taksa dhe tarifa bashkiake	1,597	-
Kamatvonesa për taksa dhe tarifa bashkiake	410	-
	<u>2,007</u>	<u>-</u>

15. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	(1,729,814)	(852,425)
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	574,114	-
Penalitet, gjoha e dëmshpërblime	2,008	-
Shpenzime për punonjësit	558,863	-
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	13,243	-
Fitimi/ (humbja) para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(1,155,700)	(852,425)
Tatim fitimi	-	-
Fitimi/ (humbja) e vitit	<u>(1,729,814)</u>	<u>(852,425)</u>

16. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

17. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

OLYMPUS FOODS TIRANA SH.P.K
Rr. "Emin Duraku" Pall. "Binjakët" Nr. 5
Tiranë - Shqipëri
NUIS: L82112027S